



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve shtetas të huaj me diploma të huaja të shkollës së mesme, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e përbashkëta të ciklit të parë dhe të dytë të integruar, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë në institucionet e arsimit të lartë

Viti Akademik 2022-2023 / Kreu IV/3		Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit
1.	Kreu IV/3, pika 1 Të gjithë kandidatët shtetas të huaj që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në IAL, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, sipas afateve të përcaktuara nga IAL-të, për çdo vit akademik, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL-ja.	<u>Për raundin e parë:</u> 15.08.2022 - 22.08.2022 <u>Për raundin e dytë:</u> 22.09.2022 – 24.09.2022 <u>Për raundin e tretë:</u> 19.10.2022 – 21.10.2022
2.	Kreu IV/3, pika 2/1 Njohja e dokumentacionit të kandidatëve të pajisur me diploma të huaja të shkollës së mesme, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre. Pas përfundimit të njohjes, QSHA-ja kryen regjistrimin e tyre përfundimtar, pajis me numër matrikullimi studentin, si dhe brenda datës së përcaktuar në kalendarin ia komunikon IAL-së.	Dhjetor 2022
3.	Kreu IV/3, pika 6 IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kriterëve të përcaktuara nga ana e tyre. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. IAL-të në datën e përcaktuar, publikojnë në mjedisë të dukshme dhe në faqen e tyre elektronike zyrtare listën jo përfundimtare të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.	13.09.2022
4.	Kreu IV/3, pika 8 IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën e përcaktuar, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.	16.09.2022
5.	Kreu IV/3, pika 9 Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës së përcaktuar. Regjistrimi i kryer konsiderohet përfundimtar dhe kandidati nuk mund të heqë dorë për t'u regjistruar në një program tjetër studimi.	18.09.2022
5.	Kreu IV/3, pika 10 Pas datës së përcaktuar, sekretaritë mësimore në njësitë kryesore e IAL-ve për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët e renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Kandidatët e shpallur fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.	26.09.2022
6.	Kreu IV/3, pika 11 IAL-të brenda datës së përcaktuar, dërgojnë pranë QSHA-së, listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. IAL-të nuk duhet të dërgojnë në QSHA të dhënat e asnjë kandidati pas kësaj date. Për të gjithë emrat kandidatë të dërguar pas kësaj date ose që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në legjislacionin në fuqi, nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja duhet të kërkojë nga IAL-ja, duke njoftuar edhe kandidatin, çregjistrimin e tyre dhe konfirmimin me shkresë zyrtare brenda një afati 10 ditor për kryerjen e procesit të çregjistrimit të kandidatit nga IAL.	24.01.2023